



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit

P-035

Prishtinë, më 29 shtator 2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S -1

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 29 SHTATOR 2015

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Sabri Hamiti, Slobodan Petroviq dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Sali Morina, Slavko Simiq dhe Müfera Şinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga Zyra e BE: Blerta Bejtullahu,

Nga OSBE: Floriana Shala,

Nga KDI: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e drejtoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 21 shtator 2015,
2. Përgatitjet për seancë plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mëparshme

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 21 shtator 2015.

2. Përgatitjet për seancë plenare të radhës:

2.1 Pikat e papërfunduara nga seanca plenare më 17 shtator 2015:

Kryesia, pas diskutimeve, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare t'i vazhdojë punimet të enjten, më 01 tetor 2015, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Letërnjoftimin,
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për treguesit gjeografikë dhe për emërtimet e origjinës,
3. Emërimi i anëtarëve të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas,
4. Emërimi i anëtarit të Komisionit për Kërkesa Pronësore.
5. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari të Bordit të RTK-së nga komuniteti serb.

Kryetari i Kuvendit i njoftoi anëtarët e Kryesisë se në emër të Kryetares së G/P të AAK-së, znj. Donika Kada-Bujupi, është proceduar një shkresë në Kryesi të Kuvendit, përmes së cilës kërkohet tërheqja e pikës së propozuar nga rendi i ditës - Interpelanca e ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Memli Krasniqi.

Kryesia, pasi u njoftua lidhur me kërkesën e lartshënuar, e hoqi pikën e propozuar nga rendi i ditës - Interpelancën e ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Memli Krasniqi.

2.2 Pika e papërfunduar nga seanca plenare më 22 shtator 2015:

Po ashtu, Kryetari i Kuvendit, i njoftoi anëtarët e Kryesisë lidhur me pikën e papërfunduar në seancën e filluar më 22 shtator 2015, dhe atë - Raportimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me Marrëveshjet e arritura në Bruksel më 25 gusht 2015.

Ai propozoi që kjo çështje të shtyhet për një mbledhje tjetër të radhës, pasi që edhe Kryeministri i Republikës së Kosovës momentalisht gjendet në udhëtim zyrtarë jashtë vendit.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozimin e lartshënuar, pikën e propozuar të rendit të ditës që ka të bëjë me Raportimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me Marrëveshjet e arritura në Bruksel më 25 gusht 2015, e shtyu për një mbledhje tjetër të radhës.

Gjithashtu, Kryesia, pas diskutimeve, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e radhës të mbahet të premten, më 02 tetor 2015, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes Bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për Projektin e Bashkëpunimit për Zhvillim: “KSV/018: Mbështetje Institucionale dhe Teknike për Sistemin e Furnizimit me Ujë në Rajonin e Mitrovicës”,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Zonën e Rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Energjinë Termike,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Dizajnin Industrial,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore,
10. Shqyrtimi i Raportit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2014,
11. Emërimi i anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.
12. Propozimi i grupeve parlamentar për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave:

1. Kërkesa e 7 (shtatë) deputetëve për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar

Kryetari i Kuvendit i njoftoi anëtarët e Kryesisë se deputetja Teuta Haxhiu, e mbështetur edhe nga 6 (gjashtë) deputetë të tjerë, ka kërkuar që Kuvendi të formojë Komision Hetimor Parlamentar për hetimin e pasurisë së Kryeshefit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, z. Murat Meha.

Ai tha se neni 65.9, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton: “Kuvendi mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve tjera publike, të cilat në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve i raportojnë Kuvendit”, andaj në bazë të këtij neni, konsiderojmë se për hetimin e pasurisë së kryeshefit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, nuk ka bazë kushtetuese, ngase Agjencia Kadastrale e Kosovës nuk i raporton Kuvendit.

Gjithashtu, Kryetari tha se z. Murat Meha, është shërbyes civil dhe nuk gëzon imunitet nga ndjekjet penale apo civile, andaj për hetimin eventual të pasurisë së tij, në çdo kohë, mund të merren organet kompetente të drejtësisë.

Në fund Kryetari konstatoi se mbështetur në dispozitat kushtetuese dhe ligjore, nuk ka bazë ligjore për të proceduar me formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar për hetimin e pasurisë së kryeshefit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, z. Murat Meha, ngase të njëjtin nuk e emëron Kuvendi dhe bën pjesë në kategorinë e Shërbyesve Civilë.

2. Kërkesa e kryetarit të komunës së Prishtinës për rinovimin e Sheshit „Adem Jashari” Kryesia çështjen e lartshënuar e shtyu për mbledhjen e radhës së Kryesisë së Kuvendit

Kryesia çështjen e lartshënuar e shtyu për mbledhjen e radhës së Kryesisë së Kuvendit.

3. Çështja e financimit të Radiotelevizionit të Kosovës

Kryesia çështjen e lartshënuar e shtyu për mbledhjen e radhës së Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari e përfundoi mbledhjen e Kryesisë në orën 11:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale